

VENDIM
Nr. 297, datë 20.4.2016

PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA DREJTORIA E SHËRBIMEVE QEVERTARE TE BASHKIA SARANDË, TË PRONËS ME EMËRTIMIN “REZIDENCË QEVERTARE”, ME VENDNDODHJE NË ZONËN KADASTRALE 8642, SARANDË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1058, DATË 16.7.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI KËSHILLIT TË MINISTRAVE, PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERTARE”

(Ndryshuar me VKM nr. 304, datë 29.4.2026)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, shkronja “b”, 5, 7, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare te Bashkia Sarandë, të pronës me emërtimin “Rezidencë Qeveritare”, me vendndodhje në zonën kadastrale 8642, sipas formularit dhe planimetrisë që i bashkëlidhet këtij vendimi, për ta përdorur për realizimin e programeve arsimore parauniversitare dhe ndërtimin e një Eko-Kampusi, *si dhe për zhvillimin e projektit “Poli i Zhvillimit Turistik Sarandë”*.

2. Prona e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, hiqet nga lista e inventarit që i bashkëlidhet vendimit nr. 1058, datë 16.7.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetë-rore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave, për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare”.

3. Bashkisë Sarandë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, Kryetari i Bashkisë Sarandë dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.


KRYEMINISTRI
Edi Rama

(Për inventarizimin e pronave të veçanta)

Bashkia: Sarandë

Fusha e përdorimit të pronës: Për realizimin e programeve arsimore

[illegible]

MIRATUAR: KESHILLI BASHKIAK SARANDË **VENDIMI NR.** **DATË**



MIRATOHET

FLORJANA KOKA

KRYETARE



KONDITIONET URBANISTIKE

SIPERFAQJA E SHESHIT TË NDËRTIMIT	20000 m ²
SIPËRFAQJA TRUALL PRONË E BASHKISË SARANDË	9200 m ²
SIPËRFAQJA SHITESË QË NEVOJITET PËR EKO-KAMPUSIN	10800 m ²
SIPËRFAQJA OBJEKTI 1 EKZISTUES (SHITËPIA E PRITJES)	313 m ²

KUFIZIME

VERIU:	ZONË INFORMALE
JUGU:	PARCELA SIPAS STUDIMIT URBANISTIK
LINDJE:	PARCELA SIPAS STUDIMIT URBANISTIK
PERËNDIMI:	PARCELA SIPAS STUDIMIT URBANISTIK



 REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA SARANDË DREJTORI I DREJTORISË SË PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT HARALLAMB KOLOI			
	SPECIALISTI I URBANISTIKËS		
	PUNOI	TAULANT HYSENI	
	PUNOI	ZYLFO PASHA	